

NIPT: K 01410001 N

PASQYRAT FINANCIARE

VITI 2017


Hartuesi

Luiza Korbi



Administratori

Sagest Ekonomi



Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2017

	Shënime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	21,817,179	26,682,924
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	25,613,531	28,660,986
Të tjera llogari të arkëtueshme	6	4,968,359	496,833
Parapagime e shpenzime të shtyra	7	19,185,038	2,945,828
Inventarë	8	539,968	433,452
Totali i aktiveve afatshkurtra		72,124,075	59,220,023
Aktivitet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	9	15,354,885	14,834,551
Aktive afatgjata jomateriale	10	880,810	1,211,114
Totali i aktiveve afatgjata		16,235,695	16,045,665
Totali i aktiveve		88,359,770	75,265,688
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	11	2,280,978	2,821,576
Detyrime tatimore	12	5,897,517	7,339,784
Të ardhurat e shtyra	13	21,127,359	18,215,054
Llogari të pagueshme te tjera	14	53,434	-
Totali i detyrimeve afatshkurtra		29,359,288	28,376,414
Detyrime afatgjata		-	-
Totali i detyrimeve afatgjata		-	-
Totali i detyrimeve		29,359,288	28,376,414
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar		8,903,000	8,903,000
Rezerva ligjore		1,224,000	1,224,000
Rezerva statutore		200,000	200,000
Rezerva tjera		36,562,274	-
Fitimi i ushtrimit		12,111,208	36,562,274
Totali i kapitalit	15	59,000,482	46,889,274
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		88,359,770	75,265,688

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



Instituti i Modelimeve në Biznes shpk
(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	16	123,254,369	150,369,427
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	17	(724,220)	(487,627)
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime		(25,527,757)	(21,761,586)
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe shpenzime të tjera	18	(12,213,110)	(10,715,616)
1) konsumueshme dhe shpenzime të tjera	18	(12,213,110)	(10,715,616)
2) Të tjera shpenzime	19	(13,314,647)	(11,045,970)
Shpenzime të personelit	20	(79,113,995)	(81,692,040)
1) Paga dhe shpërblime		(70,261,830)	(72,931,022)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore		(8,852,165)	(8,761,018)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	9,10	(3,513,307)	(3,315,599)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	21	(11,700)	(850)
Shpenzime financiare	22	2,973	41
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		2,973	41
2) Shpenzime të tjera financiare		-	-
Pjesë e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet			
Fitimi/humbja para tatimit		14,366,363	43,111,766
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(2,255,155)	(6,549,492)
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin			
1) fitimin	23	(2,255,155)	(6,549,492)
Fitimi/humbja e vitit		12,111,208	36,562,274
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		12,111,208	36,562,274

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



Instituti i Modelimeve në Biznes shpk
(Vlerat janë në Lek)


Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Rezerva të tjera	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni më 1 janar 2016	8,903,000	1,424,000	-	44,621,416	54,948,416
Totali i të ardhura gjithpërfshirëse për vitin:					
Dividendë të paguar				36,562,274	36,562,274
				(44,621,416)	(44,621,416)
Pozicioni më 31 dhjetor 2016	8,903,000	1,424,000	-	36,562,274	46,889,274
Të ardhura totale gjithpërfshirëse për vitin:					
Transferim ne rezerva te tjera			36,562,274	12,111,208	12,111,208
				(36,562,274)	-
Pozicioni më 31 dhjetor 2017	8,903,000	1,424,000	36,562,274	12,111,208	59,000,482

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 janë aprovuar nga administratori i Instituti i Modelimeve në Biznes sh.p.k më _____ dhe janë firmosur si më poshtë.

Sagjet Ekonomi
Administrator




Luiza Korbi
Financiere



Instituti i Modelimeve në Biznes shpk
(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	12,111,208	36,562,274
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare	(725,916)	503,852
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	3,513,307	3,315,599
Humbje nga nxerrja nga përdorimi i AAM-ve	-	88,675
Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	-	(9,193)
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(17,663,281)	(13,823,336)
Rënie/(rritje) në inventarë	(106,516)	(120,329)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	982,874	(11,404,285)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	(1,888,324)	15,113,257
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(3,703,337)	(6,762,227)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	-	394,168
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(3,703,337)	(6,368,059)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Dividendë të paguar	-	(44,621,416)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	-	(44,621,416)
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	(5,591,661)	(35,876,218)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	26,682,924	63,062,994
Efekt i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare	725,916	(503,852)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	4 21,817,179	26,682,924

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "Instituti i Modelimeve në Biznes shpk" është krijuar në vitin 1997, me vendim gjykate Nr. 17769 datë 23/09/1997. Veprimtaria e saj rregullohet nga statuti i saj dhe ligji Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Instituti i Modelimeve në Biznes shpk është një shoqëri shqiptare me adresë të regjistruar në Bulevardin "Gjergj Fishta", P. Pallati Nr.4, Ap.42, 45, 47 dhe 2/2, Tiranë. Shoqëria ka NIPT K01410001N. Ortakët e shoqërisë janë:

• Kelvin Ekonomi	15% ose	1,335.45 pjesë të kapitalit
• Kosta Ekonomi	15% ose	1,335.45 pjesë të kapitalit
• Sagest Ekonomi	15% ose	1,335.45 pjesë të kapitalit
• Maksi Raco	55% ose	4,896.65 pjesë të kapitalit.

Kapitali themeltar i regjistruar i shoqërisë paraqitet në vlerën 8,903,000 ALL.

Objekti i shoqërisë është në fushën informatike, import- export dhe shitje me shumicë e pakicë të pajisjeve informatike e elektronike të ndryshme.

Më 31 dhjetor 2017 shoqëria ka 82 punonjës (2016: 71).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:



2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2017	2016
EURO/Lek	132.95	135.23
USD/ Lek	111.10	128.17



3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.



3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Kapitali

Kapitali njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivit afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.



3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2017 dhe 2016 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20 %
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje zyre e informatike	Vlera e mbetur	25 %
Të tjera	Vlera e mbetur	20 %

Në rastin kur vlera e mbetur e aktivitetit në fillim të periudhës është më e vogël se 10 për qind e kostos historike të këtij aktiviteti, atëherë aktiviteti amortizohet plotësisht.

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.



3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.8. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2017 është 15% (2016: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.9. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.10. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.11. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.12. Aktivitet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Mjete monetare në bankë	21,429,483	25,270,459
Mjete monetare në arkë	387,696	1,412,465
	<u>21,817,179</u>	<u>26,682,924</u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Klientë për mallra, produkte e shërbime	25,613,531	28,660,986
	<u>25,613,531</u>	<u>28,660,986</u>

6. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Tatimi mbi fitimin	4,705,499	8,582
Garanci	262,860	488,251
	<u>4,968,359</u>	<u>496,833</u>

7. Parapagime dhe shpenzime të shtyra

Parapagime dhe shpenzime të shtyra më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Shpenzime të shtyra	19,185,038	2,945,828
	<u>19,185,038</u>	<u>2,945,828</u>



(Vlerat janë në Lek)

8. Inventari

Shoqëria ka kryer inventarizimin e gjendjeve të inventarit në fund të vitit, rezultatet e të cilit përputhen me vlerën e stokut të pasqyruar në bilanc. Në mbyllje të vitit ushtrimor janë kryer llogaritjet e sakta për pasqyrimin në rezultatin e ushtrimit të efekteve të ndryshimit të gjendjeve të inventarit. Kontabilizimi i veprimeve me stokun kryhet konform normave kontabël.

Gjendja e inventarit më 31 dhjetor 2017 është si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Mallra	539,968	433,452
	<u>539,968</u>	<u>433,452</u>



Instituti i Modelimeve në Biznes shpk
 Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
 (Vlerat janë në Lek)

9. Aktive afatgjata materiale

<i>Kosto</i>	Makineri dhe pajisje	Mjete transporti	Pajisje zyre e informatike	Të tjera	Totali
Gjendja më 1 janar 2016	2,386,291	3,891,147	9,492,290	10,480,558	26,250,286
Shtesa	162,020	3,331,440	1,921,822	1,346,945	6,762,227
Nxjerrje jashtë përdorimit	(24,583)	(1,438,547)	(828,893)	(233,974)	(2,525,997)
Gjendja më 31 dhjetor 2016	2,523,728	5,784,040	10,585,219	11,593,529	30,486,516
Shtesa	-	151,220	2,241,543	1,310,574	3,703,337
Nxjerrje jashtë përdorimit					
Gjendja më 31 dhjetor 2017	2,523,728	5,935,260	12,826,762	12,904,103	34,189,853
<i>Zhvierësimi i akumuluar</i>					
Gjendja më 1 janar 2016	1,298,729	2,539,124	5,401,294	5,479,870	14,719,017
Amortizimi i vitit	239,204	692,117	1,312,740	741,235	2,985,296
Nxjerrje jashtë përdorimit	(21,214)	(1,122,645)	(699,805)	(208,684)	(2,052,348)
Gjendja më 31 dhjetor 2016	1,516,719	2,108,596	6,014,229	6,012,421	15,651,965
Amortizimi i vitit	201,402	762,764	1,335,953	882,884	3,183,003
Nxjerrje jashtë përdorimit					
Gjendja më 31 dhjetor 2017	1,718,121	2,871,360	7,350,182	6,895,305	18,834,968
<i>Vlera neto kontabël</i>					
Gjendja më 31 dhjetor 2016	1,007,009	3,675,444	4,570,990	5,581,108	14,834,551
Gjendja më 31 dhjetor 2017	805,607	3,063,900	5,476,580	6,008,798	15,354,885



10. Aktive afatgjata jomateriale

	AAJM
Me kosto	
Gjendja më 1 janar 2016	2,202,025
Shtesa	-
Transferime	-
Pakësime	-
Gjendja më 31 dhjetor 2016	2,202,025
Shtesa	-
Transferime	-
Pakësime	-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	2,202,025
Amortizimi	
Gjendja më 1 janar 2016	660,608
Amortizimi i vitit	330,303
Pakësime	-
Gjendja më 31 dhjetor 2016	990,911
Amortizimi i vitit	330,304
Pakësime	-
Gjendja me 31 dhjetor 2017	1,321,215
Gjendja Neto me 31 dhjetor 2016	1,211,114
Gjendja Neto me 31 dhjetor 2017	880,810

11. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Furnitorë	2,280,978	2,821,576
	2,280,978	2,821,576

Llogaritë e pagueshme tregtare pasqyrojnë detyrimet për blerjen e materialeve dhe shërbimeve. Shoqëria ka mbajtur evidencë analitike për çdo furnitor.



Instituti i Modelimeve në Biznes shpk
 Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në Lek)

12. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Sigurimet shoqërore	1,435,243	1,271,011
Tatim në burim	192,051	117,881
Tatim mbi të ardhurat personale te punonjësve	851,841	2,167,120
TVSH e Pagueshme	3,418,382	3,783,772
	5,897,517	7,339,784

13. Të ardhurat e shtyra

Të ardhurat e shtyra më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Të ardhura të shtyra	21,127,359	18,215,054
	21,127,359	18,215,054

14. Llogari të pagueshme të tjera

Llogari të pagueshme të tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 detajohen si më poshtë

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Debitorë dhe kreditorë të tjerë	53,434	-
	53,434	-

15. Kapitali

Kapitali i shoqërisë është 8.903.000 Lek (8,903 kuota me 1,000 Lek vlere nominale).

	31 dhjetor 2017			31 dhjetor 2016		
	Kuotat	Vlera nominale	%	Kuotat	Vlera nominale	%
Kelvin Ekonomi	1,335.45	1,335,450	15%	1,335.45	1,335,450	15%
Kosta Ekonomi	1,335.45	1,335,450	15%	1,335.45	1,335,450	15%
Sagest Ekonomi	1,335.45	1,335,450	15%	1,335.45	1,335,450	15%
Maksi Raço	4,896.65	4,896,650	55%	4,896.65	4,896,650	55%
	8,903.00	8,903,000	100%	8,903.00	8,903,000	100%



16. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga aktiviteti	123,254,369	150,369,427
	123,254,369	150,369,427
Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së.		
Rakordimi i te ardhurave me FDP-ne	127,797,714	149,554,307
Qarkullim i tatueshëm		
Zbriten Autofaturimet	(1,631,040)	(1,260,414)
Zbriten paradhëniet	-	403,625
Shtohen të ardhurat e rimarra nga viti paraardhes	18,215,054	20,281,131
Zbriten të ardhura të shtyra për tjetër	(21,127,359)	(18,215,054)
Zbritet vlera kontabel neto e AAM-ve të shitura Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	-	(384,975)
Shtohen diferencat e kembimit te perfshira ne zerin Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	(724,220)	(496,820)
Shuma e qarkullimit e korrektuar	122,530,149	149,881,800
Sipas Kontabilitetit	122,530,149	149,881,800
Diferenca	-	-
	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Te ardhura sipas kontabilitetit	122,530,149	149,881,800
Shtohen humbjet e kembimit te perfshira ne te ardhura te tjera	737,968	503,895
Te ardhura nga interesat perfshire ne te ardhura financiare	2,973	41
te ardhura nga grantet paraqitur neto ne shpenzime	-	-
Per tu deklaruar ne FDP tatim fitimi	123,271,090	150,385,736



Handwritten blue ink signature.

(Vlerat janë në Lek)

17. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit


Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Fitime nga këmbimet valutore	13,748	7,075
Humbje nga këmbimet valutore	(737,968)	(503,895)
	(724,220)	(496,820)
Të ardhura nga shitja e AAM	-	394,168
Shpenzime nga shitja e AAM	-	(384,975)
	-	9,193
	(724,220)	(487,627)

18. Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe shpenzime të tjera

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndëve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen me veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Materiale të para	1,282,299	1,869,241
Mallra dhe programe	1,017,979	854,372
Shërbime	9,912,832	7,992,003
Blerje programesh	807,405	1,260,417
Energji elektrike e shpenzime komunikimi	5,300,957	4,296,708
Nëntrajnime e programe të tjera	1,422,079	899,501
Mirëmbajtje e riparime nga të tretë	1,562,591	741,260
Shërbime nga të tretë	819,800	794,117
	12,213,110	10,715,616



19. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Qira zyre	7,663,295	5,983,900
Taksa lokale e të tjera	161,097	131,774
Reklama	792,566	-
Transferime, udhëtime e dieta	702,717	671,617
Shërbime bankare	196,006	188,648
Dieta tej kufirit të lejuar	57,500	70,650
Shpenzime për pritje e përfaqësime	421,847	331,050
Shpenzime te panjohura	378,330	290,954
Blerje uji e materiale sanitare	635,748	680,928
AQT- jashtë përdorimit	-	88,675
Honorare	1,240,069	981,855
Shpenzime të tjera	2,255,620	1,625,919
Shpenzime të shtyra	(1,190,148)	-
	13,314,647	11,045,970

20. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Shpenzime për paga	83,439,539	72,931,022
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	10,551,302	8,761,018
Shpenzime të shtyra paga	(13,177,709)	-
Shpenzime të shtyra sigurime	(1,699,137)	-
	79,113,995	81,692,040

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2017 është 82 (2016: 71).

21. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Gjopa dhe penalitete	11,700	850
	11,700	850



[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

Instituti i Modelimeve në Biznes shpk
 Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në Lek)

22. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatin nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërise. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga interesat	2,973	41
	2,973	41

23. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
<i>Fitimi para tatimit</i>	14,366,363	43,111,766
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)	668,007	551,511
Penalitete, gjoba e dëmshpërblime	11,700	850
Shpenzime udhëtimi	57,500	70,650
Tatim i panjohur	220,469	189,057
Shpenzime të tjera	378,338	290,954
<i>Fitimi i tatueshem per periudhen</i>	15,034,370	43,663,277
<i>Norma e tatim fitimit (15%)</i>		
Shpenzime per tatim fitimin	2,255,155	6,549,492

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Tatim fitimi më 1 janar	8,582	(6,706,280)
Paguar detyrimi i vitit paraardhës	-	6,706,280
Parapagime tatim fitimi	6,952,072	6,558,074
Shpenzime tatim fitimi	(2,255,155)	(6,549,492)
Tatim fitimi i parapaguar/(për t'u paguar)	4,705,499	8,582

24. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Përfitimet e stafit drejtues	11,154,661	13,770,114
	11,154,661	13,770,114

Gjatë vitit nuk janë shpërndarë dividend (2016: 44,621,416 Lek).



(Vlerat janë në Lek)

25. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

26. Angazhimet dhe pasiguritë

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 dhjetor 2017 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

